

Kombetarja nuk gjen stadium per stervitje

nga AlbaniaSoccer
E hënë, 09 Gusht 2010 21:23



Kombetarja shqiptare ne dite e dyte te grumbullimit ne prag te miqesores me Uzbekistanin, ka hasur veshtiresi per te gjetur nje stadium ku te stervitet. Pas disa peripecirash dhe nje ore sorollatje neper kryeqytet, kuqezinjte kane mundur te sterviten normalisht, pasi Tirana ka nderprere seancen stervitore, per t'ja lene "Skender Halilin" lojtareve te Kuzhes.

Pavaresisht paralajmerimeve rreth nje jave me pare te kompleksit "Skender Halili", apo edhe te stadiumit "Selman Stermasi", stervitja ne dite e dyte te grumbullimit te perfaqesueses sone pervecse eshte shtyre ne orar nga ora 18:00 ne 18.30, ka hasur edhe veshtiresi ne gjetjen e nje vendi per t'u stervitur, gje qe e ka nervozuar jo pak trajnerin kroat Josip Kuzhe.

Ne kompleksin sportiv "Skender Halili", ne orarin e paralajmeruar per stervitjen e kombetares po zhvillonte seancen stervitore Tirana, duke i detyruar lojtaret qe te shkojne per ne stadiumin "Selman Stermasi", por edhe aty ishte e pamundur.

Ne kete stadium kishte filluar stervitjen ekipi kundarshtar i Uzbekistanit, i cili mberriti dite e sotme ne Tirane.

Konfuzioni i krijuar e nxorri 22-shen e kombetares ne nje aneks te kompleksit "Skender Halili", ne pritje te perfundimit te stervitjes se Tiranës.

Nga ora 18:00, e percaktuar per t'u zhvilluar kjo seance stervitore, trajneri dhe stafi i tij u detyruan qe te fillojne stervitjen nje ore me vonese.

Pas gjithë këtyre peripecirave, ekipi përfaqësues ka zhvilluar seancen stervitore normalisht ne dite e tij te dyte, ku trajneri Kuzhe po sheh nga afer gjendjen e lojtareve dhe po pergatitet per ndryshimet e reja te formacionit me elementet e rinj te grumbulluar.

Kombetarja nuk gjen stadium per stervitje

nga AlbaniaSoccer
E hënë, 09 Gusht 2010 21:23

Ndeshja miqesore me Uzbekistanin do te zhvillohet dite e merkure ne stadiumin e rikonstruktuar te Durrësit, "Niko Dovana", dite ne te cilen do te inaugurohet dhe impianti i ri i ndricimit.

Enea Shtrepi